



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RAPORT I VITIT 2023 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK I REALIZUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2023, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kishte planifikuar për konsultim publik 3 projektakte (1 projektligj dhe 2 projektvendime), sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2023, konkretisht;

1. Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.
2. Projektvendimin “Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë””;
3. Projektvendimin “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030”.

Nga projektaktet e mësipërme, projektvendimi “Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë”, për të cilin për shkak të rëndësisë, ndonëse nuk ishte parashikuar në planin e konsultimit, u konsultua gjatë katërmujorit të dytë të vitit 2023.

Gjatë periudhës së monitorimit, pra për periudhën Janar - Dhjetor 2023, janë miratuar projektakte të tjera të fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) 2023, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 862, datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”, për të cilat nuk u zhvillua procesi i konsultimit publik, pasi nuk janë në fushën e zbatimit të Ligjit nr. 146/2014 “Për konsultimin Publik”.

Gjithashtu, në vijim të monitorimit të platformës së Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) vihet re se për projektaktet e publikuara ka pasur një numër vizitorësh në rritje nga publiku (Qytetar/Ekspert).

Sfida për tu adresuar vijon të mbetet rritja e përfshirjes së publikut në vendimmarrje, dhe nevoja për një informim më të mirë të këtij procesi ndaj publikut.

Një problematikë që vlen të theksohet është se ka shumë vizitorë, si nga qytetarë dhe ekspertë por janë të pakët ata që lënë komente në portalin e Regjistrit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike. Megjithatë, qytetarët/ekspertët kanë pasur mundësi dhe rrugë të tjera, si përsëherë adresën e-mail për të përcjellë shqetësimet dhe paqartësitë e tyre, e cila ka rezultuar më efektive.

2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë vitit 2023

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i përgjithshëm i akteve për të cilin Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kryer konsultim publik dhe janë miratuar gjatë vitit 2023 është 3 (tre), konkretisht:

- Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Projektvendimi “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030”;
- Projektvendimi “Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë”.

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar 209 akte gjatë vitit 2023.

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

3 (tre) projektakte i janë nënshtruar konsultimit publik, të miratuara.

2.1.3 Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Është konsultuar 1 (një) projektligj me raport VNR-je, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Aktet e tjera të konsultuara nuk janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45 të Rregullores së Këshillit të Ministrave.

2.1.4 Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

- Për 23 aktet e parashikuara në Programin Analitik gjatë vitit 2022, për 18 prej tyre janë përdorur kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasi nuk janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik;

- Nga 5 aktet e parashikuara në PKIE, për 3 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

- Nga 12 aktet e parashikuara në dokumentat strategjike kombëtare dhe sektoriale, për 9 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Nga 3 projektaktet e konsultuara për vitin 2023, 1 (një) projektligj dhe 2 (dy) projektvendime.

2.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me performancën institucionale të vitit të kaluar MIE për periudhën e raportimit ka realizuar një proces efektiv konsultimi publik për projektligjin e miratuar.

2.2 Metodatat e konsultimit


2.2.1 Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhë ishin 4 (katër):

1. Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, RENJK,
2. Konsultimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sesioni Konsultimit publik,
3. Tryeza të konsultimit me ekspertë, workshope,
4. Adresa e emailit të personave të kontaktit (Drejtori Teknike, Koordinator Konsultimit Publik),
5. Takime, diskutime konsultative me Institucionet shtetëror,
6. Takim teknik me përfaqësues të huaj (Komisionit Europian, DG Near dhe DG Connect, EUD dhe Observatorin e Medias Europiane).

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e takimeve konsultative. Numri i komenteve përmes konsultimit publik nëpërmjet emailit dhe ndërmjet regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike ishin 2 (dy) komente dhe asnjë koment përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. (Të paraqitura edhe grafikisht si më poshtë)



2.2.3 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, projektligji është hartuar me kontributin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, në bashkëpunim me Ministrinë për Infrastrukturën dhe Energjinë, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave, në kuadër të grupit ndërinstitucional të punës për integrimin Evropian për Kapitullin 10, “Shoqëria e Informacionit dhe Media”.

Gjithashtu, nga ana e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Programimit, Harmonizimit dhe Standartizimit të Kuadrit Rregullator, për hartimin e projektaktit e projektvendimit “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030”, si edhe me Entin Rregullator të Ujit, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve etj.

Projektvendimi “Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë”, është hartuar Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve nga bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Programimit, Harmonizimit dhe Standartizimit të Kuadrit Rregullator.

2.3 Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për aktet e planifikuara gjatë të vitit 2023 u realizua në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për sa i përket fazave paraprake dhe më pas publikimit në RENJK, është 9 (nëntë) muaj.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata në krahasim me vitet e kaluar ka mbetur e njëjtë. Konsultimi për projektligjin e miratuar është zhvilluar bazuar mbi parimin e pjesëmarrjes dhe proporcionalitetit, duke përzgjedhur metodat dhe targetuar aktorët që ndikohen nga politika e krijuar. Situata edhe këtë vit është përmirësuar në kuadër të marrjes së kontributit dhe komenteve nga grupet e interesit, si rrjedhojë e bashkëpunimit efektiv dhe me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

10 Aktorë të jashtëm kryesisht ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve shtetërore, Organet Rregullatore, ekspert teknik të BE, shoqëria civile etj ishin pjesëmarrës në procesin e hartimit.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektakteve gjatë vitit 2023, pjesëmarrësit në tryezat e konsultimit ishin:

- ekspertë,
- përfaqësues nga organet rregullatore,
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë,
- përfaqësues nga operatorët privatë etj.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit, 9 ishin aktorët e interesit të cilët dhanë komente dhe sugjerime me qëllim përmirësimin e projektakteve.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë kryesisht nga konsultimi teknik me Ministrinë e linjës: MFE, MD, MEPJ, AKEP dhe Posta Shqiptare. Gjithashtu gjatë fazës paraprake pati sugjerime dhe kontribut edhe nga ekspertët teknik me përfaqësues të Komisionit Europian, DG Near dhe DG Connect, EUD dhe Observatorin e Medias Europiane. Në fazën e mëvonshme të

konsultimit komentet erdhën kryesisht nga shoqëria civile, konkretisht nga Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe Organizata “AWA Albanian Woman in Audiovisual”.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata për gjashtëmujorin e parë 2023 paraqitet e përmirësuar. Procesi i konsultimi ka qenë proaktiv dhe gjithëpërfshirës, duke zhvilluar konsultime të fazuara dhe mundësuar kështu pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesit.

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në regjistrin e konsultimeve publike ka pasur 2 komente/sugjerime nga Rrjeti Fuqizimit Gruas në Shqipëri dhe Organizata “AWA Albanian Woman in Audiovisual” në fazën e parë të konsultimit.

Ndërsa në adresën elektronike ka pasur 1 (një) koment nga Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe 1 (një) koment nga Organizata “AWA Albanian Woman in Audiovisual”(e njëjtë me atë në RENJK). Pranë AMA kanë paraqitur komente, sugjerime tre operatorë të medias audiovizive.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Komentet e pranuar tërësisht janë 0 (zero), të pranuar pjesërisht 1 (dy), ndërsa të refuzuara 2 (dy).

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Konstatohet se tendenca është përmirësuar.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Raporti i VNR për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, nuk është përditësuar në përfundim të procesit të konsultimit pasi reagimet e mbledhura nuk ndryshojnë implikimet e politikës së krijuar.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Për vitin 2023 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka publikuar raportin e konsultimit për projektaktin: Projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; projektvendimi “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030” si dhe projektvendimi “Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë”.

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Janë publikuar 3 (tre) raporte konsultimi për aktet e konsultuara.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Duke marrë në konsideratë metodologjinë e pikëzimit “Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, në draftin e ri pasqyrohet dhe reflektohet reagimi të palëve të interesuara”, konsultimi publik për të gjitha projektaktet e konsultuara, vlerësohen me 8 pikë.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Për sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik mund të përmendim gjithpërfshirjen e publikut, ndërmjet një angazhimi më të madh në këtë proces. Me qëllim përmirësimit të procesit të konsultimit publik, sugjerohet organizimi i konsultimeve përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik.